



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedlinica Org.Unit	SP-02
Nr. i Fajevë Br. Stranica No. Pages	1
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7808-2/22
Datë Datum Date	28.02.23
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelaria Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

DATË/A:	20.02.2023
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Behar Çunaku (si person i autorizuar) nga Korporata Energjetike e Kosovës-KEK sh.a Rr. Termocentrali Kosova B – Obiliq tel:045/898931 email: behar.qunaku@kek- energy.com
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Ndërtimore për “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit

I nderuar,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin ndërtimor për leje ndërtimi me nr. protokoli 7808/22 të datës 22.12.2022 nga parashtruesi i kërkesës z. Behar Çunaku me nr. Personal: 1001107395 (si person i autorizuar nga Korporata Energjetike e Kosovës-KEK sh.a.), Rruga Termocentrali Kosova B – Obiliq, për “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit dhe vlerëson si në vijim:

Bashkangjitur me këtë shkresë përcjellëse gjeni Vendimin për Leje Ndërtimore

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of Generaly Secretary

Data: 20.02.2023

Numri i vrojtimit të lejes: K.III-02/2023

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenet 14, 15, 19, 20, 21, Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 21, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lëshon këtë:

VENDIM

(për Leje Ndërtimore)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Korporata Energjetike e Kosovës-KEK sh.a		
Adresa:	Termocentrali Kosova B – Obiliq		
Telefoni:	+383(0)45/898931	Emaili:	behar.qunaku@kek-energy.com

Emri i Projektit:	“Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit		
Emri i Projektuesit:	"Dea Group" Sh.P.K.		
Adresa:	Rruga Prekazi, Nr. 36 Prishtinë		
Telefoni:	+383(0) 44/815477	Emaili:	deagroup0@gmail.com

Për punët ndërtimore si në vijim:

Adresa	“Ndërtimi i Objekti të SNRC-së” (Reduktimi selektiv jokatalitik) dhe infrastruktura përcjellëse, i cili është planifikuar të ndërtohet në vendndodhjen e Termocentralit Kosova B, Komuna e Obiliqit, Zona Kadastrale Obiliq, në njësitë kadastrale P-72614055-00310-2, P-72614055-00311-2 dhe P-72614055-00312-2	
Zona Kadastrale		



ZK. Obiliq	Qasja në objekt është projektuar të jetë përmes rrugës dytësore e cila lidhet me rrugën "Kosova B". Projekti i "Objektit të SNRC" (Reduktimi selektiv jokatalitik), përfshinë hapësirën për deponim të URESË së Granuluar, stacionin për shkarkimin e URESË që përfshinë transporterët me shirit dhe hinkat e zbrazjes, sistemin për tretje të URESË në ujë duke përfshirë rezervuarët dhe pompat e nevojshme për tërthorim dhe transfer, stacionin e kompresorëve, sistemin për dërgimin e masës së tretshme në kaldaja për injektim, ndërrimin e elektrofiltrave. Teknologjia e SNCR-së është teknologji për reduktimin e oksideve të azotit (NOx) pa katalizator. Metodologjia e SNCR-së është një teknologji e cila do ta shfrytëzojë URENË e Granuluar, e cila në impiantin përkatës SNCR, do të tretet me ujin tretës (të demineralizuar) i cili do të merret nga ndërtesa ekzistuese e Demineralizimit. 1. Objekti i SNCR-së: me etazhitet P+0 me dimensione 14,90 m x 24,74 m, ku janë paraparë të vendosen pajisjet e SNCR-së do të ndërtohet në nr.par. 00310-2; 00311-2 dhe 00312-2; 2. Platoja (rezervarët); me dimensione 10.80 m x 9.80 m do të ndërtohet në parcelën nr. 00310.-2 dhe nr. 00311-2;	GPS Koordinatat: 1. x=7504715.85; y=4728410.35; 2. x=7504703.23; y=4728402.15; 3. x=7504716.70; y=4728381.42; 4. x=7504729.32; y=4728389.62; 1. x=7504728.69; y=4728419.70; 2. x=7504719.64; y=4728413.82; 3. x=7504724.97; y=4728405.60; 4. x=7504734.03; y=4728411.48;
Lloji i ndërtimit:		
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐	Rrënim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:		
Kategoria I ☐	Kategoria II ☐	Kategoria III ☒
Përdorimi i propozuar:		
A përfshinë projekti ndryshim të përdorimit? Po ☐ Jo ☒		
Shtëpi ☐	Banesë kolektive ☐	Përdorim i përzier ☐ Komercial ☐
Industrial ☐	Infrastruktura ☐	Tjetër: "Ndërtimi i Objektit SNRC" (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit

Përshkrimi: “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit është ndërtim i ri dhe nuk do të ketë ndryshim të përdorimit.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të sigurojë që punëkryesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe punëkryesit, nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e autoritetit kompetent i cili ka dhënë lejen e ndërtimit – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin ndërtimor dhe ditarin e punës, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore, përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - të njofton inspektoratin e MMPHI-së mbi synimin për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - të kontaktojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi z. Behar Çunaku me nr. Personal: 1001107395 (si person i autorizuar nga Korporata Energjetike e Kosovës-KEK sh.a.), Rruga Termocentrali Kosova B – Obiliq, në baze të kërkesës me nr. protokolli 7808/22 të datës 22.12.2022 ka kërkuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, leje ndërtimi për “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit.



Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të tërësishëm ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore lëshohet duke u bazuar në shqyrtimin e këtyre provave:

- Vendimi për Kushtet Ndërtimore për projektin “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit, me nr. prot. 5232-2/22 me datë 30.11.2022 nga MMPHI;
- Vendim për Pëlqim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për projektin “Impianti i masave sekondare (SNCR) për reduktimin e NOX-it në kaldajat e TC Kosova B – Komuna e Obiliqit” me referencë 21/1911 MMPHI me numër të protokollit 1911-2/21 të datës 04.10.2021;
- Pëlqim nga Ministria e Punëve të Brendshme - Agjencia e Menaxhimit Emergjent me Nr.1475/22 të datës 08.09.2022, lëshon pëlqim të dokumentacionit investiv teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri;
- Pëlqim nga Instituti Arkeologjik i Kosovës me numër të protokollit 358/03 të datës 15.10.2021, Ju njoftojmë se në hapësirën e Termocentralit Kosova B nuk kemi gjurmë të potencialit të Trashëgimisë Kulturore Arkeologjike;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga Njoftim Departamenti i Trashëgimisë Kulturore- me numër të referencës 173/2021 të datës 06.10.2021. Nuk ka asete të trashëgimisë kulturore dhe arkitekturore në hapësirën industriale të Termocentralit Kosova B;
- Pëlqim –Ekstrakt nga Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Komuna e Obiliqit me Nr. V-554 të datës 27.04.2022. Sipas dokumentit të Planifikimit Hapësinor është hapësirë e Termocentralit dhe ndodhet brenda zonës së Termocentralit Kosova B në të cilin parashihet ndërtimi i objektit të SNCR-së;
- Kopja e Planit dhe certifikata e njësisë kadastrale me nr. P-72614055-00310-2, P-72614055-00311-2 dhe P- P-72614055-00312-2 ZK Obiliq - Komuna e Obiliqit, Pronari Korporata Energjetike e Kosovës (KEK);
- Tri (3) kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike;
- Dëshmi mbi pagesën e taksës.

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet, situacioni i ngushtë “Ndërtimi i Objektit SNRC” (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të kësaj Leje Ndërtimi.



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Nr. 189 datë: 28.02.2023 Prishtinë

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Komunës së Obiliqit,
3. Kabinetit të Ministrit,
4. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
5. Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimi,
6. Inspektoratit të MMPHI-së,
7. Arkivit të MMPHI-së

Servet Spahiu

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



N



koordinatat e gabaritit te objektit

DEPOJA		
Pikë	X	Y
01	7504715.85	4728410.35
02	7504703.23	4728402.15
03	7504716.70	4728381.42
04	7504729.32	4728389.62
PLATOJA		
05	7504728.69	4728419.70
06	7504719.64	4728413.82
07	7504724.97	4728405.60
08	7504734.03	4728411.48

LEGJENDA

	OBJEKTI I PLANIFIKUAR
	PLATOJA E PLANIFIKUAR
	OBJEKTE EKZISTUESE
	RRUGË
	IZOIPSE DHE PIKA
	NGASTRA KADASTRALE

Klienti për: KOMPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a KOSOVA 10000 PRISTINE 065 555 555 065 555 555		Projektuar nga: DEA DESIGN ENGINEERING ARCHITECTURE Adress: Mati 1, 10000, Prishtinë Mob.: +383 44 815 477 E-mail: deagroup0@gmail.com		Vendi: 	
Emri i objektit: Hartimi i planit konceptual kryesor dhe për objektin e SNCR-së		Vendi i ndërtimit: Location:		Obiliq	
Faza e dokumentit: Projekt phase:		Niveli i projektit: Project level:		Projekt Kryesor	
Projektuesi: Designer:		Ndërkuptuesi: Supervisor:			
Emri i projektit: Project:		Emri i vendit: Street name:		P-02-2021 Situacioni i Ngushtë	
Faza e dokumentit: Project phase:		Niveli i projektit: Project level:		1:500	
Emri i projektit: Project:		Emri i vendit: Street name:		A-02	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planiranja,
Gradnje i Stanovanje / Department of Spatial Planing, Construction and Housing

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCE:					
PËR/ZA/TO:		Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të (MMPHI)			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Xhemail Metolli, Zëvendësues i Udhëheqësit të Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit			
NGA/OD/FROM:		Naime Pakashitica - Zyrtare për rregullore teknike			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Vendim për Leje Ndërtimore për "Ndërtimi i Objektit SNRC" (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit			
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	1417	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	20.02.2023

I nderuar Sekretar,

Departamenti i Planifikimit Hapësinorë, Ndërtimit dhe Banimit - Divizioni i Ndërtimit, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin ndërtimor për leje ndërtimi, me nr. protokolli 7808/22 të datës 22.12.2022 nga parashtruesi i kërkesës z. Behar Çunaku me nr. Personal: 1001107395 (si person i autorizuar nga Korporata Energjetike e Kosovës-KEK sh.a.), Rruga Termocentrali Kosova B – Obiliq, për "Ndërtimi i Objektit SNRC" (Reduktimi selektiv jokatalitik) Komuna e Obiliqit dhe vlerëson si në vijim:

Me respekt,

